

NJOFTIM
Nr. 8397, datë 10.5.2022

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM
TË AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE
TË KONFISKUARA**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, kapitulli III, pika 16, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 888, datë 11.11.2020, “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”, shpallen për shitje me çmim 30% më të ulët se çmimi fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vend-ndodhja	Vlerat (në lek)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesor e	Njësi			Data	Ora	Vendi
1	Njësi shërbimi	Orikum, Vlorë	3 392 272	0	3 392 272	56.84		25.5.2022	12:00	DDPP

Shënim. Për këtë pasuri është lidhur kontratë qiraje nr. 3545 prot., datë 29.12.2021, midis AAPSK-së dhe subjektit z. Dashamir Rrucaj për periudhën 12-mujore nga data 3.1.2022 deri më datë 2.1.2023.

2. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vend-ndodhja	Vlerat (në lek)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Njësi			Data	Ora	Vendi
1	Njësi shërbimi	Orikum, Vlorë	4 683 700	0	4 683 700	78.66		25.5.2022	12:30	DDPP

Shënim. Për këtë pasuri është lidhur kontratë qiraje nr. 3545 prot., datë 29.12.2021 midis AAPSK-ja dhe subjektit z. Dashamir Rrucaj për periudhën 12-mujore nga data 3.1.2022 deri më datë 2.1.2023.

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin, si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lek, për llogari të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. Deklarimin personal të secilit pjesëmarrës, që vërteton se ky i fundit nuk është në konflikt interesi, sipas dispozitave të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 34/2019, të ndryshuar.

4. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Agjencinë e Administrimit të

Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pasi të keni tërhequr pranë kësaj agjencie faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al.